Policia me aksion në Kamenicë: Arrestohen tre persona, sekuestrohen armë e municion

LAJME

01/10/2025 13:59

Njësiti i Hetimeve të Përgjithshme nga Sektorit Rajonal të Hetimeve, Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan, pas një hetimi të gjatë dhe sigurimit të informatave nga terreni dhe në bazë të autorizimeve nga Prokuroria Themelore, ka realizuar sot një operacion të gjerë policor në disa lokacione të ndryshme.

Operacioni është zhvilluar në orët e hershme të mëngjesit, ku njësitet policore, kanë kryer bastisje në disa lokacione në komunën e Kamenicës, të identifikuara paraprakisht përmes punës operative hetimore policore ndaj një grupi të personave më dyshimin se të njëjtit janë përfshirë në veprat penale si "Detyrimi", "Posedim i substancave narkotike" dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".

Gjatë kontrollit shtëpitë dhe objektet përcjellëse të personave të dyshuar janë gjetur dhe sekuestruar:

- Para në vlerë 8700 Euro
  - 1 granatë dore
  - 1 revole TT me një karikator me shtatë fishekë cal.7.62 mm
  - 145 fishekë cal.7.62 mm
  - 1 karikator
  - 201 fishekë të cal.7.62×39 mm
  - 1 sprej piper
  - 1 gëzhojë 7.62×39 mm
  - 1 cigare e mbushur me substancë të dyshuar marihuanë, me peshë 1.1 gr.

SONY DSC

SONY DSC

SONY DSC

Si rezultat i këtij operacioni, janë arrestuar tre persona të dyshuar meshkuj kosovarë: A.K. (viti i lindjes 1988), A.K. (viti i lindjes 1986), dhe B.Th., të cilët me urdhër të prokurorit janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

LAJME TË FUNDIT

Barcelona përpara, Torres i pandashëm – i shënon gol të bukur Parisit

Përparim Rama: Trafiku nuk zgjidhet me hapjen e...

Serie A publikon një video të Zhegrovës duke...

Zemaj: VV-ja po e faktorizon Listën Serbe

Artikuj të ngjashëm

October 1, 2025
Përparim Rama: Trafiku nuk zgjidhet me hapjen e sheshit, kemi realizu...

October 1, 2025
Zemaj: VV-ja po e faktorizon Listën Serbe

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy